



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Nr. 196 prot.

Kamëz, më 21/12 2022

**V E N D I M**

Nr. 169 Datë 21/12/2022

**PËR**  
**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PER PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM**  
**2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR 2024.**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. **21.12.2022**, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr. **150** dt **19.12.2022**,

- Në mbështetje të nenit 54, të Ligjit nr. nr. **139/2015**, “Per Veteqeverisjen Vendore” të VKM-Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë”, Ligji nr. 10 296, dt. 08.07.2010 , “Per Menaxhimin financiar dhe kontrollin“, në Ligjin nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- ne Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2023-2025 ”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”.

**V E N D O S I**

1. Miratimin e kalendarit të përgatitjes se programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024, bashkëlidhur pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Ky Vendim i shtrin efektet nga data 01.01.2023.
3. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

  
**KRYETAR**  
**HYSEN KOLDASHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK KAMËZ

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM( 2024-2026) DHE BUXHETIT  
VJETOR viti 2024

Nr	Aktiviteti	Struktura përgjegjese	Afati
1.	Parqitja për shqyrtim e miratim te Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesem te te Ardhurave	Drejtoria e Te Ardhurave	Deri 31 Janar 2023
2.	Miratim nga Keshilli Bashkiak i Raportit; për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesem te te Ardhurave .	Keshilli i Bashkise	Deri 01.03.2023
3.	Pergatitja e tavaneve te shpenzimeve te PBA 2024-2026 nivel programi. Diskutimi ne takimin e GMS	Grupi per Menaxhim Statgjik	Deri 01.03.2023
4.	Miratimi i tavaneve te shpenzimeve te buxhetit afatmesem PBA 2024-2026	Keshilli i Bashkise	Brenda 15 Marsit 2023
5.	Pergatitja dhe miratimi i udhezimit te pergatitjes se PBA dhe buxhetit Vjetor dhe shperndarja ne NJ.Shpenzuese .	Kabineti i Kryetarit Sekretetari GMS (Dr,finances )	Brenda Marsit 2023
6.	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore	Njesite shpenzuese të bashkisë	21 Mars -25 Prill 2023
7.	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2024-2026	Njësia e vetëqeverisjes vendore	26 Prill - 27 Prill 2023
8.	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura	Njësitë shpenzuese të Bashkisë	28 Prill - 30 Prill 2023
9.	Organizon seancat dëgjimore me Banorët	Kryetari i NJQV-së	16 Maj - 26 Maj 2023
10.	Prezanton dokumentin e PBA 2024-2026 me shoqërinë	Kryetari i NJQV-së	27 Maj - 29 Maj 2023

	civile		
11.	Hartimi i dokumentit te pare te PBA 2024-2026, Diskutimi ne takimin e GMS. Dergimi ne MF i Projekt dokumentit te PBA	G.M.S Kryetari i Bashkise	Brenda dt 01.06.2023
12.	Shqyrtimi dhe miratimi nga keshilli Bashkiak i Projektin e pare te PBA , duke su njohur edhe me rekomandimet e Ministrise se Financave.	Keshilli Bashkiak	Brenda 30 Qershorit 2023
13.	Pergatitja e tavaneve perfundimtare te PBA ne nivel programi , pas daljes se udhezimit plotesues te pergatitjes se buxhetit vendor nga Ministria e Financave.	Drejtoria e Finances	Brenda Qershorit pas daljes se UMF v.2023
14.	Miratimi i tavaneve perfundimtare te PBA 2024-2026	Keshilli Bashkiak	Brenda 20 Korrikut 2023
15.	Pergatitja e udhezimit per pergatitjes e Buxhetit te njesise se veteqeverisjes vendore dhe shperndarjen tek Njesite Shpenzuese : a.tavanet perfituese b.afatet e pergatitjes se kerkeses te rishikimit te PBA 2024-2026.	Sekretari GMS  Drejtoria e Finances	5 dite pas miratimeve te tavaneve
16.	Pergatitja e projektit te rishikuar te PBA 2024-2026. Organizimi i seancave degjimore me komunitetin ( Nj. Administrative , Lagjet e e Qytetin , Grupet e interesit, shoqeria civile ) Hartimi i planit te masave dhe veprimit per organizimin e degjesave publike per PBA-ne .	Kabineti i Kryetarit  Sekretari i GMS	Korrik – Gusht v.2023
17.	Miratimi i PBA te rishikuar ne Keshillin Bashkiak Njohja e Keshillit me rekomandimet e dhena nga MF	Keshilli Bashkiak	Brenda 15 shtator 2023
18.	Pas miratimit te PBA te rishikuar pergatitja e Projekt Buxhetit Vjetor , parashikimi per cdo ze te ardhure dhe shpenzimi: Per cdo program. Per cdo Njesi shpenzuese.	Drejtorite e Bashkise , Ndemarrjet dhe Institucionet e varesise	Tetor -10 Nentor v.2023
19.	Miratimi nga Keshilli Bashkiak i Buxhetit Vjetor	Keshilli Bashkiak	Dt 24.12.2023

	dhe i PBA perfundimtare 2024-2026.		
20.	Dergimi i nje kopjeje te Buxhetit Vjetor dhe i PBA perfundimtare 2024-2026, ne Ministrine e Financave.	Sekretari GMS	5 dite nga data e miratimit
21.	Publikimi i Buxhetit Vjetor dhe i PBA perfundimtare se bashku me dokumentacioni shoqerues Ne faqen zyrtare te Bashkise Buletini e Njoftimeve Publike	Drejtoria e Burimeve Njerezore	5 dite pas miratimt nga Keshilli Bashkiak

  
**KRYETAR**  
**HYSEN KOLDASHI**  
